

# Statistikat e Transportit Rrugor

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

## Metadata Referenciale

1. Kontakt .....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	4
5. Periudha e referencës .....	4
6. Mandati institucional .....	4
7. Konfidencialiteti .....	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	6
11. Manaxhimi i cilësisë .....	7
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	9
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	9
17. Rishikimi i të dhënave .....	9
18. Përpunimi statistikor .....	10
19. Komente.....	10
Aneks .....	10

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit, Drejtoria e Statistikave Ekonomike.
1.3. Personi i kontaktit	Olsa Ulqinaku
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit.
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, Kodi Postar 1017, Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:agaqi@instat.gov.al">agaqi@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	27.10.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	27.10.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	27.10.2023
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat e Transportit Rrugor përfshijnë informacion mbi numrin gjithsej të mjeteve rrugore me status "aktiv" dhe "të çregjistruar përkohësisht" që qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto statistika përfshijnë informacione për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mjetet rrugore sipas llojit;</li> <li>• Mjetet rrugore sipas qarqeve;</li> <li>• Mjetet rrugore sipas markës;</li> <li>• Mjetet rrugore sipas llojit të regjistruara për herë të parë</li> <li>• Mjetet rrugore sipas qarqeve të regjistruara për herë të parë</li> <li>• Mjetet rrugore sipas markës të regjistruara për herë të parë</li> </ul> <p>Statistikat e Transportit Rrugor të prodhuara nga INSTAT nuk përfshijnë</p>

	flukset e mallrave dhe pasagjerëve të transportit rrugor. Këto të dhëna nuk sigurohen nga burime administrative apo vrojtime të realizuara nga INSTAT.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Nuk aplikohet
3.3. Mbulimi i sektorit	Informacioni statistikor mbulon të dhënat për Transportin Rrugor të kryer në Republikën e Shqipërisë.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><b><u>Transport Rrugor</u></b></p> <p><b>Transport</b> - Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave. duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.</p> <p><b>Transporti rrugor</b> - Çdo lëvizje e mallrave duke përdorur një mjet rrugor në një rrjet të caktuar rrugor.</p> <p><b>Autoveturë</b> - Mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh, në të cilin numri i vendeve të uljes (duke përfshirë edhe shoferin) nuk e kalon numrin 9.</p> <p><b>Autobus</b> - Mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh me numrin e vendeve të uljes (duke përfshirë dhe vendin e shoferit) me më shumë se 9 vende.</p> <p><b>Kamion</b> - Mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave.</p> <p><b>Motor</b> - Mjet motorik i transportit rrugor me dy, tre ose katër rrota që nuk i kalon 400 kg peshë pa ngarkesë.</p> <p><b>Rimorkio për transport mallrash</b> - Mjet rrugor për transportin e mallrave i projektuar për t'u tërhequr nga një mjet motorik i transportit rrugor.</p> <p><b>Automjete për transport të përzier (ATP)</b> - Përfshihen mjetet që kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjësë, duke përfshirë dhe ndenjësën e drejtuesit të mjetit.</p> <p><b>Automjete për transport të veçantë (ATV)</b> - Mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të vecanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përbashkët, me mekanizma special që i shërbejnë këtij qëllimi.</p> <p><b>Automjete për përdorim të veçantë (APV)</b> - Mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të vecantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe i materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me</p>

	<p>destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.</p> <p><b><u>Eksportet/importet e mallrave</u></b></p> <p><b>Eksportet</b> - Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.</p> <p><b>Importet</b> - Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.</p>
3.5. Njësia statistikore	<p>Njësitë statistikore sipas llojeve të transportit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mjetet rrugore, me status "aktiv" dhe “të çregjistruar përkohësisht” që qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</li> <li>• Ndërmarrjet eksportuese/importuese të cilat kryejnë aktivitet në transportin hekurudhorë.</li> </ul>
3.6. Popullata statistikore	<p>Popullata statistikore përfshin numrin e mjeteve rrugore, me status "aktiv" dhe “të çregjistruar përkohësisht” që qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>
3.7. Zona e referencës	<p>Të dhënat e statistikave të transportit rrugorë mbulojnë të gjithë territorin e vendit.</p>
3.8. Mbulimi në kohë	<p>Statistikat e Transportit e rrugor datojnë prej vitit 2019.</p>
3.9. Periudha bazë	<p>Nuk aplikohet.</p>
<b>4. Njësia matëse</b>	<p>Të dhënat mbi Statistikat e Transportit rrugor publikohen vetëm në vlera absolute dhe përqindje. Njësia matëse në transportin rrugor, për mjete rrugore është numri i mjeteve rrugore, me status "aktiv" dhe “të çregjistruar përkohësisht” që qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>
<b>5. Periudha e referencës</b>	<p>Periudha referuese e informacionit statistikor mbi Statistikat e Transportit Rrugor është tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2023.</p>
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Baza ligjore në nivel kombëtar për prodhimin e indikatorëve për statistikave të Transportit janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”</a>;</li> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026</a>;</li> <li>• Vendimet e Këshillit të Statistikave.</li> </ul> </li> <li>➤ Sipas rregulloreve përkatëse të BE-së janë:</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullorja e e Parlamentit dhe Këshillit Evropian <a href="#">Nr. 70/2012, datë 18 Janar 2012</a> “Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin e mallrave me rrugë”</li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	<p>Statistikat e Transportit nuk transmetohen në EUROSTAT. Aktualisht, INSTAT plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtare në lidhje me statistikën e transportit, të tilla si: Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE), Federata Ndërkombëtare e Rrugëve (IRF), Common Questionnaire, etj.</p>
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31, i Ligjit Nr 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë</p>

	përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendarin e publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit, në fund të vitit paraardhës. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	<a href="#">Kalendarin</a> i publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it.
8.3. Aksesin i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe të përdoren të gjitha format e mundshme të mediave. INSTAT dhe agjencitë statistikore, që kanë në program përgjegjësitë e shpërndarjes, kërkojnë të plotësojnë çdo kërkesë të ndonjë organizate ose individit për të dhëna të pabotuara ose analiza specifike. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Website – press release;</li> <li>2. Kërkesat e shkruara;</li> <li>3. Publikimi <a href="#">“Statistikat e Transportit”</a></li> <li>4. <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a>, seksioni për përdoruesit e jashtëm.</li> </ol>
<b>9. Shpeshhtësia e shpërndarjes</b>	Statistikat e Transportit shpërndahen në baza tremujore dhe vjetore.
<b>10. Aksesin në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të Statistikave të Transportit rrugor: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numrin e mjeteve rrugore sipas llojit, qarqeve dhe markës;</li> <li>• Numrin e mjeteve rrugore të regjistruara për herë të parë sipas llojit, qarqeve dhe markës.</li> </ul> Njoftimi për shtyp në lidhje me Statistikat e Transportit Rrugor publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Statistikat e Transportit Rrugor gjenden të botuara në botimin “Vjetarin Statistikor Rajonal” dhe “Shqipëria në shifra”. Përdoruesit mund t’i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT: <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Statistikat e Transportit</a></li> <li>• <a href="#">Vjetari Statistikor Rajonal</a></li> <li>• <a href="#">Shqipëria në Shifra</a></li> </ul>

10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat mbi Statistikat e Transportit Rrugor publikohen në faqen zyrtare të INSTAT në seksionin: <a href="#">Databaza</a>
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31, Ligji Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për <a href="#">Kontakt</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologjia është e bazuar në manualët dhe rregulloret e EUROSTAT mbi Statistikat e Transportit, të cilat përmbajnë një set të gjerë rekomandimesh mbi plotësimin e treguesve për llojet e ndryshme të transportit. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">Metodologjinë</a> e përdorur mbi Statistikat e Transportit.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ndjekura lidhur me Statistikat e Transportit Rrugor për qëllime të brendshme.
<b>11. Menaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në Ligjin Nr.17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT, për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e Transportit krahasohen me të dhënat e Transportit të tremujorit paraardhës për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.

<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e të dhënave të transportit janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucione të administratës publike</li> <li>• Universitete</li> <li>• Organizata jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare</li> <li>• Biznese</li> <li>• Kërkuar shkencorë, studentë dhe grupe të tjera të ngjashme.</li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikime (Page Views) në lidhje me Statistikat e Transportit për vitin 2022 janë rreth 2.071 klikime.</p> <p>Gjatë 2022, INSTAT ka kryer vërtetimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vërtetimit tregojnë se cilësia e përgjithshme mbi “Statistikat e Transportit” është vlerësuar me 3.69 (73,8%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave të Transportit Rrugor për tremujorin, gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar nga INSTAT nga ato të kërkuara nga rregulloret e ndjekura. Nuk sigurohet informacion për transportin rrugor të mallrave apo pasagjerëve.</p> <p>Shkalla e plotshmërisë së të dhënave për Statistikat e Transportit Rrugor dhe Hekurudhor, është afërsisht 40%.</p>
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Të dhënat për Transportin Rrugor mblidhen në mënyrë administrative në zbatim të bazës ligjore dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit. Nuk kryhen vërtetime për të dhënat e transportit. Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Nuk aplikohet pasi të dhënat janë administrative.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm human. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.</p>



<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Statistikave të Transportit Rrugor janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 27 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+27 ditë).</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>9/30/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>10/27/2023</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>27</td> </tr> </table>	Periudha referuese	9/30/2023	Data e publikimit	10/27/2023	Afatet kohore	27		
Periudha referuese	9/30/2023								
Data e publikimit	10/27/2023								
Afatet kohore	27								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat për Statistikat e Transportit Rrugor publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave të Transportit Rrugor ka qënë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>9/30/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>10/27/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>10/27/2023</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	9/30/2023	Data e shpallur	10/27/2023	Data e publikimit	10/27/2023	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	9/30/2023								
Data e shpallur	10/27/2023								
Data e publikimit	10/27/2023								
Vonesa në kohë	0								
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat që INSTAT prodhon janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e EUROSTAT. Statistikat e Transportit Rrugor prodhohen në nivel vendi.								
15.2. Krahasueshmëria kohore	Informacioni statistikor i transportit rrugor grumbullohet në mënyrë vjetore duke filluar nga viti 2014. Nga viti 2023 e në vazhdim të dhënat publikohen çdo tremujor.								
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.								
15.4. Koherenca e brendshme	Përpara finalizimit të të dhënave, kontrollohet konsistenca e brendshme e tyre. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca e tyre në seri të ndryshme.								
<b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b>	Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave të transportit pranë Sektorit të Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit është: 1 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT.								
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>									
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të statistikave të transportit hartohen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë, referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve</a></li> </ul>								

17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast se autoritetet lokale do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara pranë INSTAT, informacioni përditësohet dhe publikohet në publikimin e muajit të ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Statistikat e Transportit” për vitin 2023, subjekt i këtij raporti.</p>
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	Burimi i vetëm i të dhënave të transportit është burimi administrativ. Të dhënat grumbullohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Mbulimi është në nivel vendi, të dhënat janë administrative dhe informacioni statistikor mundësohet në kohë.
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mbi statistikën e Transportit Rrugor grumbullohen në baza tremujore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat e Transportit Rrugor janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor grumbullohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe detajohet sipas mjeteve rrugore të regjistruara në vend, në frekuencë tremujore.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave të Transportit Rrugor ju kryhen kontrolle logjike dhe matematike. Këto kontrolle realizohen për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon, gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
<b>19. Komentë</b>	
<b>Aneks</b>	